

# AKTGJYKIMET E PLOTËFUQISHME PËR KRIMET E LUFTËS NË KOSOVË GJATË VITIT 2023

JANAR - DHJETOR 2023



## PËRMBAJTJA

PROKURORI KUNDËR SVETOMIR BAÇEVIQIT

PROKURORI KUNDËR ZORAN VUKOTIQIT -  
VUKOTIQ IV

PROKURORI KUNDËR REMZI SHALËS



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK), që nga përfundimi i konfliktit të armatosur në Kosovë, monitoron proceset gjyqësore për krimet e luftës pranë gjykatave të Kosovës. FDHK në vazhdimësi ka publikuar dhe do të publikoj analiza të rasteve dhe buletine, që do t'i shërbejnë publikut të gjerë për të qenë më të informuar mbi këto procese gjyqësore.

Në këtë buletin janë paraqitur informacionet për tre (3) raste të krimeve të luftës në Kosovë, të cilat kanë përfunduar me aktgjykime të plotfuqishme gjatë periudhës së vitit 2023.

Gjatë kësaj periudhe kohore nga gjykatat e Kosovës janë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë tre (3) raste: Prokurori kundër Svetomir Baçeviqit, Prokurori kundër Zoran Vukotiqit (Vukotiq IV) dhe Prokurori kundër Remzi Shalës.

# PROKURORI KUNDËR SVETOMIR BAÇEVIQ

---

Kolegji i Departamentit Special i Gjykatës së Apelit, i kryesuar nga gjyqtari Burim Ademi, në datën 19 janar të vitit 2023 morri aktgjykimin me të cilin i refuzoi ankesat e palëve në procedurë dhe e konfirmoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës/Priština, ku i pandehuri Baçeviq është dënuar me pesë (5) vite burgim për krimet e luftës kundër popullatës civile.

Në datën 9 nëntor 2021 prokurori special i PSRK, Ilir Morina, e ngriti aktakuzën kundër të pandehurin Svetomir Baçeviq sepse ekzistonte dyshim i bazuar se i pandehuri gjatë muajve korrik – gusht 1998 në fshatin Bellopojë/Belo Polje të Komunës së Pejës/Peć, e morri peng të dëmtuarën T.K, një grua rreth moshës gjashtëdhjetë (60) vjeçare, e cila më pas u lirua nga një fqinj tjetër serb.

Para se të ngritët aktakuza në datën 18 qershor dhe 16 korrik të vitit 2021 janë mbajtur seancat e mundësisë së hetuesisë së veçantë ku është dëgjuar e dëmtuara T.K.

Gjatë shqyrtimit kryesor janë dëgjuar edhe gjashtë (6) dëshmitarë të tjerë të propozuar nga prokuroria.

Trupi gjykues i Departamentit Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Pristina, i kryesuar nga gjyqtari Musa Konxheli, në datën 8 shtator të vitit 2022 të pandehurin Baçeviq e shpalli fajtor dhe e dënoi me pesë (5) vite burgim. Ky vendim është konfirmuar edhe nga shkalla e dytë.

# PROKURORI KUNDËR ZORAN VUKOTIQIT – VUKOTIQ IV

---

Kolegji i Departamentit Special i Gjykatës së Apelit, i kryesuar nga gjyqtarja Afërdita Bytyçi, në datën 15 shkurt të vitit 2023, morri aktgjykimin me të cilin e ka miratuar pjesërisht ankesën e prokurorisë ku të pandehurit Vukotiq iu konfirmua aktgjykimi dënues i shkallës së parë për krimet e luftës kundër popullatës civile.

Gjykata e Apelit e dënoi me trembëdhjetë (13) vite burgim sepse i pandehuri morri pjesë në dëbimin e popullatës civile shqiptare dhe në kryerjen e dhunimit seksual të një gruaje të nacionalitetit shqiptarë.

Aktakuza kundër të pandehurit Zoran Vukotiqit u ngrit nga prokurorja speciale e PSRK-së, Drita Hajdari, në datën 06 mars të vitit 2020.

I pandehuri akuzohej se në maj të vitit 1999 në Vushtrri/Vučitrn, si pjesëtarë i forcave policore të njësisë rezerve të MPB të Serbisë, morri pjesë në dëbimin, kryerjen e dhunës fizike dhe psikike të popullatës civile shqiptare si dhe kreu dhunimin seksual të një gruaje të nacionalitetit shqiptarë.

Në datën 21 janar të vitit 2021 filloi shqyrtimi kryesor me fjalët hyrës të palëve në procedurë. Gjatë shqyrtimit kryesor është dëgjuar e dëmtuara D.1 dhe gjashtë (6) dëshmitarë të propozuar nga prokuroria.

Në datën 5 korrik 2021 trupi gjykues i Departamentit Special të Gjykatës Themelore të Prishtinës/Priştina, i kryesuar nga gjyqtarja Valbona Musliu Selimaj, e shpalli fajtor të pandehurin dhe e dënoi me dhjetë (10) vite burgim.

Në datën 21 dhjetor 2021 kolegji i Gjykatës së Apelit e ktheu rastin në rigjykim.

Në datën 25 tetor 2022 ka filluar rigjykimi me dëgjimin e të dëmtuarës/dëshmitares D1, kurse deklaratat e dëshmitarëve të tjerë me propozim të palëve janë marrë si të lexuara.

Në datën 11 nëntor 2022 është shpallur aktgjykimi i shkallës së parë dhe i pandehuri prapë është dënuar me dhjetë (10) vite burgim.

Përfundimisht Gjykata e Apelit me aktgjykim të plotfuqishëm e shpalli fajtor të pandehurin Vukotiq dhe e ashpërsoi dënimin në trembëdhjetë (13) vite burgim.

Ky është aktgjykimi i parë fajësues i formës së prerë nga gjykatat vendore për dhunim seksual si krim lufte kundër popullatës civile që nga përfundimi i luftës në Kosovë.

## PROKURORI KUNDËR REMZI SHALËS

Kolegji i Departamentit Special i Gjykatës së Apelit, i kryesuar nga gjyqtari Kreshnik Radoniqi, në datën 05 dhjetor të vitit 2023 morri aktgjykimin me të cilin i refuzoi si të pabazuara ankesat e palëve në procedurë kurse ankesën e palës së dëmtuar e hudhi si të palejuar. Me këtë aktgjykim është konfirmuar aktgjykimi i shkallës së parë i Gjykatës Themelore të Prizrenit me të cilin i pandehuri Remzi Shala është shpallur fajtor për veprën penale krim i luftës kundër popullatës civile dhe është dënuar me nëntë (9) vite e gjashtë (6) muaj burgim.

Aktakuza kundër Remzi Shalës është ngritur nga prokurori special i PSRK-së, Haki Gecaj, në datën 19 tetor 2016.

I pandehuri akuzohej se në fund të qershorit 1998 në fshatin Duhël/Dulje të Komunës së Suharekës/Suva Reka, në cilësinë e pjesëtarit të UÇK-së dhe në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë, e ka marr forcë nga shtëpia Haxhi Përteshin, trupi i të cilit pas disa ditësh u gjet pa shenja jete.

Shqyrtimi kryesor ka filluar në datën 12 majt të vitit 2017. Gjatë shqyrtimit kryesor janë dëgjuar tridhjetë (30) dëshmitarë.

Në datën 03 korrik të vitit 2019, trupi gjykues i Gjykatës Themelore të Prizrenit e ka shpallur aktgjykimin dënues dhe të pandehurin e ka dënuar me katërmbëdhjetë (14) vite burgim.

Në datën 26 nëntor të vitit 2019 kolegji i Departamentit Special i Gjykatës së Apelit e zbuti dënimin në dhjetë (10) vite burgim.

Në datën 02 mars të vitit 2020, kolegji i Gjykatës Supreme e miratoi kërkesën për mbrotje të ligjshmërisë të parashtruar nga mbrojtësi i të dënuarit dhe lënda u kthye në rigjykim në shkallën e parë.

Shqyrtimi kryesor në rigjykim filloi në datën 24 qershor të vitit 2020 pranë Gjykatës Themelore të Prizrenit. Gjatë rigjykimit në shqyrtimin gjyqësor janë dëgjuar tridhjetë e pesë (35) dëshmitarë.

Në datën 27 qershor të vitit 2023, trupi gjykues i Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore të Prizrenit e shpalli aktgjykimin fajësues dhe e dënoi të pandehurin me nëntë (9) vite e gjashtë (6) muaj burgim.

Dëshmia kryerore kundër të pandehurit Shala ka qenë dëshmia e dëshmitarit/dëmtuarit Agron Përteshit i cili e ka identifikuar të pandehurin si person i cili e ka marrë me forcë nga shtëpia babain e tij.

Në datën 05 dhjetor 2023, kolegji i Gjykatës së Apelit e morri aktgjykimin me të cilin u konfirmua aktgjykimi i shkallës së parë.

## GJETJET E FDHK:

-Monitoruesit e FDHK kanë evidentuar një performancë të mirë në procesimin e gjykimeve për krimet e luftës nga gjyqtarë të Departamentit Special të Gjykatës Themelore të Prishtinës/Priştina dhe Departamentit Special të Gjykatës së Apelit. Procedurat gjyqësore për krimet e luftës pranë këtyre departamenteve kryhen brenda një kohe të arsyeshme.

-Në kontekstin e historisë së proceseve gjyqësore për krimet e luftës në Kosovë, aktgjykimi kundër Zoran Vukotiqit për dhunë seksuale si krim lufte kundër popullatës civile, është një precedent i rëndësishëm, si aktgjykim i parë fajësues i formës së prerë nga gjyqësori vendor.

-Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore të Prizrenit, rastin Prokurori kundër Remzi Shalës, e ka gjykuar si rast të fundit për veprën penale krim i luftës kundër popullatës civile të trajtuar nga Departamentet për Krime të Rënda të gjykatave rajonale, pasi që me hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykatat, nga janari i vitit 2019, rastet e krimeve të luftës trajtohen ekskluzivisht vetëm nga Departamenti Special i Gjykatës Themelore të Prishtinës/Priştina.

Ky publikim përkrahët financiarisht nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës përmes projektit "Avancimi i procesit të pajtimit përmes qasjes përfshirëse dhe holistike ndaj ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë" dhe nga organizata National Endowment for Democracy përmes projektit "Promovimi i dialogut dhe të kuptuarit historik".

Përmbytja e këtij publikimi është përgjegjësi e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës dhe organizatës National Endowment for Democracy.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA



SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë  
Fond za humanitarno pravo Kosovo  
Humanitarian Law Center Kosovo